



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

**Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,  
trajtimin ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues**

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/345  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

**Nr.**                      **Prot.**  
**Nr. Dok. 202300109/1**

**Tiranë** \_\_\_/\_\_\_/2023

**Lënda:**            *Rekomandime për inspektimin e bërë në ambientet e Komisarariatit të Policisë Nr.6, Tiranë.*

**Drejtuar:**    **Z. Vilson BALA**  
                  **Shef i Komisarariatit të Policisë Nr.6**

**TIRANË**

**Për dijëni:**    **Z. Tonin VOCAJ**  
                  **Drejtori i DVP Tiranë**

**TIRANË**

**Z. Muhamet RRUMBULLAKU**  
**Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit**

**TIRANË**

*I nderuar Z. Bala,*

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimin ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar kreu një inspektim në Komisariatin e Policisë nr. 6, Tiranë.

Inspektimi u krye në datën 01.02.2023, sipas një Plani Vjetor Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin znj. Nertila Qafzezi dhe znj. Gloria Çarkaxhiu me detyrë Nd/ Komisionere pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014, "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde "Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre", Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019,

për miratimin e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimeve të mëparshme.

Avokati i Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i mëparshëm, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t’ju parashtojë konkluzionet përfundimtare, duke ju referuar si më poshtë vijon:

### **Shënime të përgjithshme**

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas të privuar nga liria, grupi inspektues u takua me shefin e komisariatit z. Vilson Bala dhe zëvendës shefin e komisariatit z. Sokol Myrta të cilët u vunë në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Në vijim të takimit, z. Bala informoi grupin e inspektimit, mbi masat e marra për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Avokati i Popullit referuar inspektimit të mëparshëm, lidhur me përmirësimin e kushteve të ambienteve të shoqërimit dhe të sigurisë të këtij Komisariati sipas procedurave standarde dhe për rritjen e performancës së punonjësve të policisë për respektimin e të drejtave ligjore të shtetasve të shoqëruar, arrestuar/ndaluar.

Grupi i inspektimit, shoqëruar nga zëvendës shefi i komisariatit vijoi inspektimin në ambientet e shoqërimit të Komisariatit, vizitoi zyrat e punonjësve të policisë, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me persona e shoqëruar të arrestuar apo ndaluar.

Drejtuesi dhe punonjësit në Komisarlatin e Policisë nr.6 Tiranë, me të cilët kontaktoi grupi i inspektimit, u treguan bashkëpunues gjatë gjithë inspektimit që u zhvillua ambientet e këtij Komisariati.

Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm<sup>1</sup>, rezultoi se:

1. Nuk ishte realizuar rekomandimi për marrjen e masave të menjëhershme për vënien në përdorim kapaciteteve të reja në ambientet e Komisariatit të Policisë nr.6 Tiranë për marrjen në pyetje të të shoqëruarve sipas standardeve posaçërisht për intervistimin e tyre dhe dhënien fund të praktikës së dërgimit të tyre në zyrat e Oficerëve të Policisë Gjyqësore.

---

<sup>1</sup> Rekomandimi i dërguar me nr. K4/I22-2Prot, datë 22.07.2022.

2. Nuk ishte realizuar rekomandimi për marrjen e masave të nevojshme për të siguruar që personat e ndaluar nga policia të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre që nga fillimi i heqjes së lirisë dhe të ndërpritet praktika e dhënies së saj pas marrjes në pyetje nga Oficerët e Policisë Gjyqësore.

Ndërkohë ishte plotësuar pjesërisht rekomandimi mbi:

1. Dhomat e shoqërimit ishin pajisur vetëm me nga një stol të palëvizshëm por mungonin orenditë e nevojshme si karrige, tavolina si dhe lyerjen e ambienteve të dhomave të shoqërimit sikurse përcaktohet në procedurat standarde.

Në përfundim, grupi inspektimit konstatoi se, në Komisarariat e Policisë nr.6 Tiranë **nuk ishin marrë masa për përmirësimin e standardeve** lidhur me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar, duke veçuar mosvënien në funksion të zyrës për marrjen në pyetje të të shoqëruarve dhe dhënien e kartës së të drejtave të shoqëruarve që në momentin e parë të shoqërimit në Komisarariat. Nuk kemi pasur një përgjigje zyrtare për rekomandimin e fundit dërguar pranë institucionit tuaj nëpërmjet shkresës nr.K4/I22-2Prot, datë 22.07.2022, lidhur me masat e marra për zbatimin e tyre. Për sa më sipër duke qenë se rekomandimi ka implikim minimale buxhetore por ndikim thelbësor në zbatimin e të drejtave të individëve kërkon trajtimin urgjent të kësaj problematike nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe marrjen e masave disiplinore për mostrajtimin në përputhje me ligjin të rekomandimeve të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2022.

Avokati i Popullit shpreh shqetësimin se ndërsa disa çështje për tu përmirësuar kanë implikime buxhetore, për disa moszbatimi tregon neglizhencë në garantimin e standardeve ligjore që lidhen me trajtimin e personave të ndaluar e shoqëruar. Nisur nga kushtet aktuale vazhdonin të ishin të pranishme problematikat, si më poshtë vijon:

### **Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre**

Në Komisarariat e Policisë nr. 6, Tiranë, ambientet e shoqërimit të cilat janë ndërtuar rishtazi sipas legjislacionit në fuqi<sup>2</sup> përbëheshin nga 3 (tre) dhoma shoqërimi të ndara më vete, një dhomë për qëndrimin e personave të rritur, një

---

<sup>2</sup>Ligji Nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, dhe procedurave standarde të parashikuara në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Nr. 925, datë 18.07.2019, “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, si dhe Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr. 938, datë 24.07.2019, “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”.

dhomë për qëndrimin e grave dhe një dhomë për mbajtjen dhe shoqërimin e të miturve.

Dhomat e shoqërimit plotësonin standardet me sipërfaqe dhe hapësirë të bollshme për personat e shoqëruar në konflikt me ligjin, përgjatë vitit 2022 dhomat e shoqërimit ishin pajisur me nga një stol të palëvizshëm por mungonin orenditë e tjera të nevojshme, tavolina e karrige për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar, të cilat të jenë të fiksuara dhe të pa lëvizshme për trajtimin dinijtoz të shtetasve të shoqëruar<sup>3</sup>.

Dritaret e dhomave të shoqërimit ishin me përmasa të tilla që lejonin ajrimin e plotë dhe hyrjen e dritës natyrale. Dhomat kishin ndriçim dhe furnizim nga rrjeti elektrik. Në pjesën e jashtme, dritaret e dhomave të shoqërimit ishin të siguruar me qëllim parandalimin e largimit apo arratisjes së personave të shoqëruar në këto mjedise.

Në ambientet e shoqërimit gjendej një dhomë për takimin me avokatët për personat e shoqëruar, e cila ishte e pajisur me tavolina, karrige. Ky ambient nuk ishte i monitoruar me kamera.

Në hyrje të ambienteve të dhomave të shoqërimit, gjendej dhe një dhomë për njohje në interes të hetimit të personave të shoqëruar në konflikt me ligjin. Dhoma ishte e pajisur me tavolinë karrige dhe e monitoruar me kamera.

Mjedisi dhe dhomat e shoqërimit ishin të rikonstruktuar rishtas<sup>4</sup> dhe përgjithësisht të mirëmbajtura dhe të pastra nga ana higjieno-sanitare. Në hyrje të korridorit të dhomave të shoqërimit ndodheshin dy tualete, të ndara më vete për gra dhe burra sipas standardeve të miratuara. Ato ishin të pastra dhe të pajisur me dushe, lavaman dhe ujë të rrjedhshëm 24 orë, korridoret dhe dhomat e shoqërimit ishin të monitoruara me kamera. Po ashtu, dhomat e shoqërimit si dhe godina e Komisarariatit të Policisë nr. 6 në Tiranë, kishte sistem qendror ngrohje/ftohje, por konstatoam se ky sistem ishte jashtë funksionit dhe **në dhomat e shoqërimit nuk kishte ngrohje.**

Godina e Komisarariatit nr.6 në Tiranë, si ambientet e brendshme dhe në pjesën e jashtme të saj, ishte survejuar nga sistemi i kamerave përgjatë 24 orëve. Gjatë inspektimit, u konstata se në këtë komisarariat zbatoheshin detyrimet ligjore të

---

<sup>3</sup>Procedura standarde e punës për : “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit ” Urdhër, nr 938 date 24.07.2019, pika 4. Kushtet e mbajtjes dhe Siguria për personat e shoqëruar, Në mjediset ku pyetet i shoqëruari të kenë të vendosura pajisje e orendi pune për specialistët e ndihmës specialistët e policisë si; tavolina e karrige si dhe stola për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar, të cilat të jenë të fiksuara dhe të pa lëvizshme.

<sup>4</sup> Komisarirati nr. 6 Tiranë është rikonstruktuar më 11.01.2019.

parashikuara në nenet 109 paragrafi 5<sup>5</sup> dhe 122 paragrafi 5<sup>6</sup> e ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në Kapitullin VIII, pika a.3.4<sup>7</sup> të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimit të çështjes përkatëse.

Në Komisariatin e Policisë nr.6 Tiranë, gjatë periudhës 01.01.2023 deri më 01.02.2023 ishin të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar dhe të evidentuar në regjistrin e shoqërimit **127** persona, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 109 dhe 112 paragrafi 1 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” i ndryshuar. Në momentin e inspektimit nuk kishte asnjë shtetas në dhomat e shoqërimit.

Gjithashtu, na informuan se personat e shoqëruar nga policia janë të informuar për të drejtat e tyre, që nga fillimi i privimit të lirisë, duke siguruar informacion të qartë verbal në lidhje me të drejtat ligjore/procedurale që ata kanë. Përgjatë inspektimit konstatuam se përsëri ashtu si edhe përgjatë viteve të shkuara personave të shoqëruar, nuk i ‘u jepej karta e të drejtave siç dhe parashikohet nga legjislacioni i procedurës penale. **Mekanizmi Kombëtar kërkon dhënien e kartës së të drejtave në formë shkresore që në momentin e hyrjes në Komisarjat**<sup>8</sup>.

**Sa më sipër është rekomandimi i bërë nga KPT dhe i përsëritur nga Mekanizmi Kombëtar në disa raporte inspektimi të Avokatit të Popullit, shpreh keqardhjen e thellë për mosplotësimin e këtij standardi e detyrimi ligjor.**

### **Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar dhe evidentimi i tyre**

<sup>5</sup> Neni 129 paragrafi 5 i Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar parashikon se: *“Punonjësi i policisë, dokumenton në proces-verbal veprimet e kryera me personin e shoqëruar. Procesverbali nënshkruhet në fund të çdo flete nga punonjësi i policisë që ka kryer veprimet dhe personi i shoqëruar. Një kopje e procesverbalit i vihet në dispozicion personit të shoqëruar.”*

<sup>6</sup> Neni 122 paragrafi 5 i Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” i ndryshuar parashikon se: *“Veprimet e mësipërme për marrjen e masave mbrojtëse ndaj personave të parashikuar në këtë dispozitë, dokumentohen në procesverbal. Procesverbali nënshkruhet në fund të çdo flete nga punonjësi i policisë që ka kryer veprimet dhe personi/at që kanë qenë të pranishëm gjatë kryerjes së këtyre veprimeve. Një kopje e procesverbalit i vihet në dispozicion personit, ndaj të cilit janë marrë masat mbrojtëse, ose familjarit/kujdestarit të tij.”*

<sup>7</sup> Urdhër, nr. 938 datë 24.07.2019 “Procedura standarde e punës për: “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit” a.3 - Proces verbali i veprimeve të kryera me personin e shoqëruar: a.3.4 “Procesverbali hartohet në dy kopje, një kopje e procesverbalit i jepet detyrimit personit të shoqëruar dhe kopja tjetër dorëzohet në sekretari/arshivën e njësisë policore.”

<sup>8</sup> CPT u bën thirrje autoriteteve shqiptare të ndërmarrin hapa për të siguruar që personat e ndaluar nga policia të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre që nga fillimi i heqjes së lirisë (domethënë, nga momenti kur ata janë të detyruar të qëndrojnë në polici).

*Kjo duhet të sigurohet me dhënien e informacionit të qartë verbal që në fillim, për t’u plotësuar në rastin më të shpejtë (domethënë, menjëherë pas mbërritjes në ambientet e policisë) me sigurimin e fletës së informacionit të lartpërmendur. Personave në fjalë duhet t’u kërkohej të nënshkruajnë një deklaratë që vërteton se ata kanë marrë një kopje të fletës së informacionit.*

**Raporti CPT-së për Shqipërinë CPT/Inf (2019) 28 [par.24]. Konsulto: <https://rm.coe.int/168097986b>.**

Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisarlatin nr.6 Tiranë, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte plotësuar në zbatim të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, sipas tipit “Model nr.1”, konform procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr.938 datë 24.07.2019 e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar.

Personat e shoqëruar në mjediset e policisë, sipas dispozitave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezulton se koha e qëndrimit në gjendje shoqërimit të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri 10 orë në raste të veçanta. Përgjatë këqyrjes së këtij regjistri konstatoam se rubrika e regjistrit mbi njoftimin e familjarëve nuk ishte e plotësuar në mënyrë korrekte, pasi në regjistër nuk ishte i shënuar emri i familjarit të njoftuar me numrin e telefonit përkatës, por ishte shënuar nga specialisti i policisë vetëm “njoftuar familjari” e cila nuk identifikon familjarin i cili ka marrë dijeni<sup>9</sup>.

Gjithashtu, në këtë Komisarlat administrohej regjistër për të miturit të shoqëruar në konflikt me ligjin ku evidentoheshin të gjithë rastet e të miturve të shoqëruar në këto ambiente, në të cilin u konstatua se të gjithë rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte dhe regjistri ishte i sekretuar.

Ndërkohë u konstatua se në këtë komisarlat kishte edhe regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 “Kërkesë/ankesat e të shoqëruarve, të ndaluarve dhe të arrestuarve” të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por nuk ishte evidentuar asnjë kërkesë apo ankesë.

Në këtë komisarlat, punonjësit e policisë zbatonin detyrimin ligjor të parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë, që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimit e çështjes përkatëse. **Nga këqyrja e “procesverbalit të Shoqërimit”, konstatoam se në këto procesverbale shoqërimi nuk shënohej ora faktike kur ata janë shoqëruar për**

---

<sup>9</sup> Masat mbrojtëse, veçanërisht në fazat e hershme të shoqërimit, janë thelbësore për të parandaluar abuzimet. Këto masa përfshijnë: dhënien e informacionit të të shoqëruarve për të drejtat e tyre; sigurimin e aksesit të një avokati; njoftimin e anëtarëve të familjes dhe/ose një palë të tretë për personin.

**në organin e policisë, pra orën kur personit i është privuar liria por vetëm ora kur përpilohet procesverbali përkatës nga oficeri i policisë gjyqësore.**

**Ambientet e sigurisë/kushtet e tyre dhe trajtimi i të ndaluarve/arrestuarve dhe i të shoqëruarve.**

Në Komisariatit e Policisë nr.6 Tiranë, nuk kishte ambiente sigurie. Personat të arrestuar/ndaluar, pasi përfundonin veprimet procedurale nga punonjësit e policisë, dërgoheshin në “Bllokun e Sigurisë Tiranë”.

### **Ambientet e intervistimit**

Në Komisariatit e Policisë nr. 6 Tiranë, oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e tyre. Këto zyra nuk ishin të monitoruara dhe ndërkohë në këtë organ nuk kishte ambiente të veçanta intervistimi të monitoruara me kamera gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore<sup>10</sup>.

Krijimi i zyrave të veçanta ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra, është rekomandim i Avokati i Popullit referuar standardeve ndërkombëtare<sup>11</sup>, të cilat e konsiderojnë procesin e monitorimit filmik si një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e Policisë së Shtetit. Ky standard ka gjetur rregullim edhe në procedurën standarde të miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 925, datë 18.07.2019, “*Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit,*

---

<sup>10</sup> “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohen në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkësë të bërë nga i ndaluar gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” Raporti i CPT-së për Armeninë: CPT/Inf (2016) 31 [par.20].  
<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016806bf46f>

<sup>11</sup> “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkësë të bërë nga i ndaluar gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” Raporti i CPT-së për Armeninë: CPT/Inf (2016) 31 [par.20].

Konsulto:

<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016806bf46f>

*evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”, duke u shndërruar në rregull të detyruar për punonjësit e policisë.

Theksojmë se vijon të mbetet shqetësuese ndjekja e praktikës së marrjes në pyetje të të shoqëruarve në zyrën e punës së specialistit/oficerit të policisë gjyqësore në Komisaratin nr. 6. Një praktikë e tillë bie ndesh edhe me Urdhrin e mësipërm të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 925, datë 18.07.2019, i cili në pikën 5 *“Rregullat e sigurisë gjatë marrjes në pyetje/intervistim dhe takimeve të ndryshme me të arrestuarin/ndaluarin”* parashikon veçanërisht kryerjen e kësaj procedure në një ambient të posaçëm siç është dhoma e intervistimit/marrjes në pyetje.

Nga monitorimi i zyrave të punonjësve të policisë, nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale.

### **Ndihma juridike, psikologjike dhe kujdesi mjekësor**

Në këtë Komisariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenet 109 paragrafi 5 dhe 122 paragrafi 5 e ligjit nr. 108/2014 *“Për Policinë e Shtetit”*, i ndryshuar, si dhe në Kapitullin VIII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimit të çështjes përkatëse.

Nga pyetja e punonjësve të policisë rezultoi se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë të cilët nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej avokat nga lista të dërguar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut që ofrohej menjëherë nga DVP Tiranë. Në Komisaratin nr. 6 mbahej regjistër i veçantë për evidentimin e të dhënave për personat e shoqëruar të mitur dhe deri në ditën e monitorimit ishin shoqëruar gjithsej 6 të mitur përgjatë muajit janar 2023.

Gjatë inspektimit u konstatua se në korridoret e godinës të këtij komisariati ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe mund të jetë e aksesueshme nga të shoqëruarit në mjediset e policisë ose t’u jepet në hyrje një kopje. Posterat duhet të vendosen në ambientet e shoqërimit pasi përgjatë kalimit në korridor nuk garantohet leximi dhe kuptimi i tyre nga të shoqëruarit.



Për sa më sipër dhe me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike” dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,

### **REKOMANDOJMË:**

1. Marrjen e masave për moszbatimin e rekomandimeve të përsëritura të Avokatit të Popullit duke nxjerrë përgjegjësinë e drejtuesve përgjegjës.
2. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e ambienteve të përshtatshme ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe dhënien fund të praktikës së dërgimit të tyre në zyra.
3. Marrjen e masave për dhënien e kartës së të drejtave në formë shkresore që në momentin e hyrjes në Komisarariat për personat e shoqëruar.
4. Marrjen e masave për plotësimin me korrektësi të “Procesverbalit të Shoqërimit”, duke shënuar orën faktike kur ata janë shoqëruar për në organin e policisë, pra orën kur personit i është privuar liria dhe jo vetëm orën kur përpilohet procesverbali përkatës nga oficeri i policisë gjyqësore.
5. Marrjen e masave për vendosjen e posterave me të drejta në ambientet e shoqërimit pasi përgjatë kalimit në korridor nuk garantohet leximi dhe kuptimi i tyre nga të shoqëruarit.
6. Marrjen e masave për plotësimin me korrektësi rubrikën njoftimi i familjarëve tek regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar dhe evidentimi i tyre në këtë regjistër.
7. Marrjen e masave për vënien në funksionim të sistemit qendror ngrohje/ftohje në komisariatin e policisë nr.6 Tiranë.

Për qëndrimin dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**KOMISIONER**

**Ahmet PRENÇI**